ATENTAT MAFIOZ, 3 TË VRARË NË FUSHË-KRUJË

POP 5 Lajmet më të lexuara të 5 minutave të fundit

1 U bë shkrumb brenda makinës së atentatit në Fushë-Krujë, reagon boksieri i njohur për vdekjen e Brilant Martinaj: Na e bëre zemrën copë

2 Saga e vrasjeve që s'ka fund/ Plani për ekzekutimin e tij dështoi, por rivalët po ia eliminojnë miqtë Ervis Martinajt

3 U vra sot në atentatin e Fushë-Krujës, kush ishte Brilant Martinaj kushëriri i Ervis Martinaj dhe vrasja e efektivit Prela në Lezhë (FOTO)

4 Fiorua, ekonomisti afgan që i iku luftës dhe punon te shezlonget në plazhin privat në Shëngjin: Ende s'kam mësuar shqip, problemi i vetëm

5 E vërteta mbi zbulimin e naftës dhe gazit në Shqipëri, flasin ekspertët: Zona e Shpiragut, 'e lakmuar' prej dekadash

Kronikë

3 të ekzekutuar në Fushë-Krujë, mes tyre kushëriri i Ervis Martinajt! Hakmarrje mes grupeve kriminale, 60 plumba makinës së viktimave, 2 u dogjën brenda (VIDEO)

Diklen Vata, A. Hoxha dhe Brilant Martinaj** janë vrarë në një atentat në mbikalimin e Fushë-Krujës. 4 **dyshohet se ishin atentatorët** të cilët kanë qenë **të maskuar,** njëri prej tyre drejtues i **mjetit i cili më pas u gjet i djegur** tërësisht në fshatin Larushkë. Brenda makinës së autorëve janë gjetur **1 armë automatike MP5 dhe 2 kallashnikovë.

- Saga e vrasjeve që s'ka fund/ Plani për ekzekutimin e tij dështoi, por rivalët po ia eliminojnë miqtë Ervis Martinajt
- Detaji tronditës, njëri prej viktimave doli nga makina i gjallë por autorët vijonin e qëllonin
- Vrasja mafioze, zbardhen emrat e 2 viktimave të tjera! Njëri prej tyre, kushëri i Ervis Martinajt! I përfshirë në vrasjen e Xhulio Prelës
- VIDEO/ E shkrumbuar totalisht, ja pamjet e makinës së autorëve! Brenda iu gjet një armë kallashnikov
- Identifikohet njëri prej viktimave në Fushë-Krujë, Diklen Vata 30-vjeç! I arrestuar më parë për trafik droge
- Një prej viktimave doli nga makina por nuk mbijetoi, dy të tjerët u dogjën brenda
- Doli nga automjeti pas atentatit, del FOTO e njërit prej viktimave! I shtrirë në tokë pak metra larg makinës së shkrumbuar
- FOTOLAJM/Atentati në Fushë Krujë ku u vranë 3 persona, forcat RENEA mbërrijnë në vendngjarje

HOROSKOPI

RAPORTO! Chat live me Shqiptarja.com

Redaksia
17 Korrik, 14:29 | **Përditesimi i fundit: 17 Korrik, 19:43**

Tre persona u ekzekutuan në mbikalimin e Fushë –Krujës mesditën e së dielës gjatë një atentati të mirëorganizuar. 30 vjecari Diklen Vata dhe 22-vjeçari Brilant Martinaj, kushërinj, si dhe shoku i tyre A. Hoxha të tre nga Kurbini po udhëtonin me një mjet Volkswagen Passat nga Fushë-Kruja në drejtim të Lacit, kur rreth orës 14:00 nga një makinë tjetër po Volkswagen u qëlluan me breshëri automatiku. sipas të dhënave të marra në vendin e ngjarjes, por edhe sipas burimeve policore besohet se ndaj tyre u derdhën rreth 60 plumba nga 3 persona që i dolën mjetit të viktimave përballë, ndërsa një i katërt drejtonte makinën e autorëve.

Diklen Vata mundi të dalë nga makina, por autorët që ishin ende në vendngjarje e janë kthyer dhe kanë qëlluar ndaj tij me një tjetër breshëri duke u siguruar që 30 vjeçari të mos mbijetonte e duke e lënë të vdekur në mes të rrugës. Dy të tjerët, Hoxha dhe Martinaj mbetën të bllokuar brenda mjetit që shpërtheu në flakë, duke djegur plotësisht trupat e tyre. Ende nuk ka të dhëna të sakta nga se u shkaktua zjarri në mjetin e viktimave.

[Sh] .com



LEXO EDHE:
U bë shkrumb brenda makinës së atentatit në Fushë-Krujë, reagon boksieri i njohur për vdekjen e Brilant Martinaj: Na e bëre zemrën copë

Policisë iu deshën më shumë se dy orë për të bërë verifikimet në vendin e ngjarjes dhe për të bërë identifikimin e viktimave për shkak të djegies së plotë të trupave. Trupat e 3 viktimave u larguan nga vendngjarja me një autoambulancë, rreth 3 orë pas atentatit, për t'u dërguar në morgun e Tiranës ku do të kryhet ekspertiza mjeko-ligjore.

Viktimat e ngjarjes së rëndë që dyshohet për hakmarrje mes grupeve kriminale nuk janë emra të panjohur për drejtësinë. Diklen Vata, një shpërndarës i drogave të forta ishte arrestuar nga policia në 2017. Kurse Brilant Martinaj, kushëri i Ervis Martinaj ka qenë I dyshuar për vrasjen e ish efektivit e FNSH Xhuljano Prela në dhjetor 2020.

Mjeti Volksagen Passat, i cili dyshohet se u përdor nga 3 autorët u gjet i djegur në fshatin Larushk, shumë pranë Fushë Krujës, ndërsa brenda tij u gjetën 1 armë automatike MP5 dhe 2 kallashnikovë. Targa e mjetit rezulton e vjedhur. Policia ngriti grupe kontrolli në të gjithë zonën, ndërsa për hetime në vendngjarje mbërritën drejtuesit më të lartë të policisë.



Foto nga vendi i ngjarjes

Rendit zhvillimet sipas orarit: Të Fundit

Ora 17:45

Dalin FOTOT/ Stresi mik i ngushtë me 2 prej të vrarëve sot në Fushë-Krujë?



Këngëtari Stresi duket se ka pasur lidhje me 2 prej të vrarëve sot në masakrën e Fushë-Krujës. Në rrjetet sociale ka foto të tij me Brilant Martianaj ndërkohë që në një foto duket në foto edhe me një person tjetër, që mendohet se është Diklen Vata.

Kujtojmë se Brilant Martinaj është kushëri i Ervis Martinajt,i dyshuar për vrasjen e efektivit Prela por që më pas i janë tërhequr akuzat.





Ora 17:33

Atentati në Fushë-Krujë, 4 dyshohet se ishin autorët



4 mësohet se kanë qenë autorët   e përfshirë në atentatin e Fushë-Krujës që ndodhi mesditën e sotme. Fillimisht, u raportua se ishin 3 autorë. Dyshohet se kanë qenë 4 veta (autorë), ku tre kanë dalë nga mjeti dhe kanë qëlluar para mjetit në drejtim të viktimave.

Ora 17:15

Shenja të plumbash në disa dhjetëra metra, Kallashnikovit nuk i shpëtoi as ndarësja e rrugës

Shenja plumbash në ndarësen e 2 korsive në aksin rrugor Fushë Krujë-Thumanë janë konstatuar në disa dhjetëra metra në vendin e ngjarjes, ku u ekzekutuan Brilant Martinaj, Diklen Vata dhe Besmir Hoxha.

Ora 16:51

VIDEO/ Momenti kur largohen nga vendngjarja trupat e viktimave dhe skeleti i makinës së tyre

Në këto pamje shikoni momentin kur me ambulancë, e shoqëruar me forca të shumta policie, po transportohen për në morg trupa e viktimave të atentatit mafioz në Fushë-Krujë pasditen e sotme. Gjithashtu po zhvendoset nga vendngjarja edhe makina me të cilin ata po udhëtonin, e cila është djegur totalisht.

Ora 16:37

Detaji tronditës, njëri prej viktimave doli nga makina i gjallë por autorët vijonin e qëllonin



Në pak minuta tre të vrarë te Mbikalimi i Fushë-Krujës, në një zonë me lëvizje të shumta, shpesh herë me trafik tepër të ngarkuar. Diklen Vata, ishte i vetmi nga 3 viktimat i cili doli nga automjeti i gjallë por autorët kanë vazhduar ta qëllojnë deri sa u siguruan që edhe ai humbi jetën.

Ora 16:31

VIDEOLAJM/ Momenti kur mjeti i viktimave në Fushë Krujë shpërthen gjatë djegies

Në pamjet e siguruara nga Report Tv duket momenti kur makina e 3 viktimave, Diklen Vata, Brilant Martinaj dhe Besmir Hoxha ka shpërthyer. Dyshohet se në mjetin e viktimave tip Volkswagen mund të ketë pasur edhe armë zjarri çka shpjegon shpërthimin e makinës në vendin e ngjarjes.

Ora 16:19

VIDEO/ E shkrumbuar totalisht, ja pamjet e makinës së autorëve! Brenda iu gjet një armë kallashnikov

Pamjet që shikoni janë të makinës së autorëve të vrasjes së trefishtë sot në Fushë-Krujë. Automjeti tip Volkswagen Passat është i djegur tërësisht. Kujtojmë se policia njoftoi zyrtarisht se në automjet është gjetur një armë zjarri.

Ora 16:10

3 ishin vrasësit e masakrës në Fushë-Krujë, njëri shofer dhe 2 të tjerët qëlluan nga të gjitha anët

POLICIA RRUGORE
112

Gazetari i Report Tv Arsen Rusta ka bërë me dije se autorët e vrasjes së trefishtë në Fushë-Krujë dyshohet se kanë qenë 3 persona, njëri prej tyre shofer dhe 2 të tjerët kanë dalë nbga makina dhe kanë qëlluar nga të gjitha anët.

Ora 16:07

U vra sot në atentatin e Fushë-Krujës, kush ishte Brilant Martinaj kushëriri i Ervis Martinaj dhe vrasja e efektivit Prela në Lezhë (FOTO)



Një nga viktimat e atentatit në Fushë Krujë që ndodhi ditën e sotme, Brilant Martinaj ka qenë ***i dyshuar për vrasjen e Xhulio Prelës*** në Lezhë. Xhulio Prela efektivi i policisë është vrarë mbrëmjen e 5 nëntorit të 2020 ku një prej autorëvë dyshohej të ishte Brilant Martinaj, kushëriri Elvis Martinaj.

Intenerari ishte lokalizuar nëpërmjet qelizave telefonike dhe është kryer përafërsisht në orarin kur mendohet se është kryer dhe vrasja e policit. Disa ditë pas ngjarjes së 5 nëntorit, mësohet se Brilant Martinaj u larguar në drejtim të Turqisë, për shkak të problemeve me shëndetin e një familjari.

Policia njoftoi se Prela dhe 2 personat, kanë filluar konfliktin për shkak të ***dritave të gjata*** të makinës. Burime për Report Tv thanë se ishte akoma e paqartë se kush e ka nisur konfliktin i pari, i cili çoi deri në ekzekutimin e 26-vjeçarit Prela.

Efektivi i FNSH-së, Xhulio Prela u ekzekutua në orët e para të mëngjesit të datës ***5 dhjetor*** me një plumb në gjoks teksa po kthehej nga Shkodra për në Tiranë. 26-vjeçari ishte nisur nga Tirana për në ***aeroportin e Rinasit*** në orën 01:00 të natës për të marrë një mikun e tij e për ta dërguar drejt fshatit Kosmaç në Shkodër.

Pasi e dërgoi mikun e tij në Shkodër, gjatë kthimit efektivi i policisë ka parë një automjet, dhe një person që kishte dalë nga makina, po ia bënte me drita me një elektrik dore. Hetuesit dyshuan se punonjësi i policisë Prela, ka menduar që personi që ia ka bërë me drita, ka kërkuar ndihmë, ndaj dhe Prela është kthyer mbrapsht. Ai ka kthyer makinën me sens drejtimi nga Tirana në Lezhë, dhe i është afruar personin që ia ka bërë me dritë. Ka ulur xhamin dhe ka parë një individ, që sipas policisë, ka shumë gjasa që ta ketë njohur. Punonjësi i policisë ka tentuar të largohet me shpejtësi, ndërkohë është përballur me të shtënat e armës, një pistoletë tip TT që kishte agresori.

Brilant Martinajt iu përmend emri edhe në vrasjen e një ish-efektivi të uniformave blu, 60-vjeçarit Xhelal Reçi, ngjarje që tronditi qytetin e Laçit në orët e para të mëngjesit të 1 nëntorit të vitit të shkuar.

Ora 15:56

Vrasja mafioze, zbardhen emrat e 2 viktimave të tjera! Njëri prej tyre, kushëri i Ervis Martinajt! I përfshirë në vrasjen e Xhulio Prelës

POLICIA
POLICIA

Besmir hoxha dhe Brilant Martinaj dyshohet se janë 2 të vrarët e tjerë në atentatin mafioz të Fushë-Krujës. Brilant Martinajt është kushuri i Ervis Martinajt dhe i dyshuar për brasjen e Xhulio Prelën në vitin 2020.

Ora 15:44

Masakra me 3 të vrarë, Policia jep njoftimin zyrtar! Çfarë u gjet brenda automjetit të autorëve

Masakra me 3 të vrarë, policia jep njoftimin zyrtar. Në automjetin e autorëve është gjetur një armë tip kallashnikov.

> *"Në aksin rrugor Fushë Krujë-Thumanë, te mbikalimi i Fushë Krujës, dyshohet se në drejtim të një automjeti tip "Volsëagen Passat" është qëlluar me armë zjarri. Si pasojë automjeti ka marrë flakë dhe janë djegur në automjet dy shtetas ende të pa identifikuar. Gjithashtu, nga të shtënat ka mbetur i vrarë dhe shtetasi D. V., 30 vjeç, nga Fushë Mamurrasi, i cili ka qenë pasagjer por ka mundur të dalë nga automjeti, dhe ka humbur jetën sapo ka dalë prej tij.*
>
> *Në vendngjarje ndodhet grupi hetimor dhe forca të shumta Policie. Nga krehja e zonës, në Larushkë, është gjetur duke u djegur një automjet tip "Volsëagen Passat" që dyshohet se është i autorëve.*
>
> *Në brendësi të automjetit është konstatuar një armë zjarri automatike që dyshohet se është përdorur nga autori/ët për të kryer krimin. Në ndihmë të Policisë vendore kanë shkuar grupe të FNSh Tiranë dhe janë ngritur pika kontrolli nga DVP Tiranë e Lezhë. Grupi hetimor nën drejtimin e Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Krujë, po punon për identifikimin e dy shtetasve të djegur në automjet dhe për sqarimin e rrethanave të ngjarjes, sekuestrimin e cdo prove të vlefshme që do ti shërbejë zbardhjes së ngjarjes dhe identifikimit të autorëve"*

Ora 15:31

Ekzekutimi i 3 personave në Fushë-Krujë, gjendet një mjet i djegur në Larushk! Dyshohet se është i atentatorëve

POLICIA
POLICIA

Ekzekutimi i 3 personave në Fushë-Krujë, gjendet një mjet i djegur në Larushk! Dyshohet se është e atentatorëve. Bëhet fjalë për një automjet të tipit Volksëagen Pasat.

Ora 15:26

Atentati në Fushë Krujë ku u vranë 3 persona, 2 prej viktimave 'shkrumb e hi' në makinë! I pamundur identifikimi, njëri me precedent penal



Nga atentati në Fushë Krujë ku mbetën të vrarë 3 persona ka zbuluar njërin prej viktimave, Diklen Vata 30 vjeç me precedent penal. Ndërsa 2 viktimat e tjerë nuk janë identifikuar ende pasi janë bërë shkrumb në mjetin e djegur

Ora 15:23

Identifikohet njëri prej viktimave në Fushë-Krujë, Diklen Vata 30-vjeç! I arrestuar më parë për trafik droge

Report Tv ka siguruar emrin e e njërit prej viktimave të atentatit në Fushë-Krujë. Bëhet fjalë për 30-vjeçarin Diklen Vata, I arrestuar në vitin 2017 me drogë.

Ai është arrestuar në shtator të 2017 si shpërndarës kokaine. Vata ishte arrestuar nga shërbimet e policisë të Drejtorisë Vendore Tiranë më datë 27.09.2017, pasi gjatë kontrollit fizik të ushtruar ndaj këtij shtetasi në vendin e quajtur zona e shkollës "Bajram Curri", iu gjet e fshehur në çorape një mbështjellëse me lëndë narkotike e dyshuar e llojit kokainë, si dhe 3 mbështjellëse të tjera të fshehura në çelësat e makinës.

Ora 15:11

FOTOLAJM/Atentati në Fushë Krujë ku u vranë 3 persona, forcat RENEA mbërrijnë në vendngjarje

Forcat RENEA kanë mbërritur në atentatin që ndodhi në Fushë Krujë ku mbetën të vrarë 3 persona. Report Tv mëson se mjeti mori flakë në ecje.

Ora 15:07

Atentat mafioz në Fushë-Krujë, hakmarrje mes grupeve kriminale! 60 plumba mjetit që ishin viktimat

Të tjera detaje tronditëse nga ngjarja e rëndë e ndodhur në Fushë-Krujë Breshëri kallashnikovi, rreth 60 plumba. Është bërë pritë mbi urën e Fushë-Krujës. Dyshohet se persona të maskuar kanë dalë para automjetit duke qëlluar me breshëri por nuk kanë qëlluar askënd tjetër përveç shënjestrës së tyre. Kemi të bëjmë për hakmarrje ndaj grupeve kriminale. Flakët janë shuar. Për kilometra të tëra është krijuar radhë në autostradë. Dy prej viktimave kanë pësuar djegie ekstreme.

Ora 14:57

Doli nga automjeti pas atentatit, del FOTO e njërit prej viktimave! I shtrirë në tokë pak metra larg makinës së shkrumbuar



Report Tv ka siguruar fotografinë e njërit prej viktimave të atentatit në mbikalimin e Fushë-Krujës. Bëhet fjalë për Diklen Vata, 30 vjeç. Ai ka dalë nga automjeti që u qëllua me kallashnikov, por nuk i ka mbijetuar dot plagëve.

Ora 14:53

Atentati me 3 të vrarë në Fushë-Krujë! Një person doli nga makina por nuk mbijetoi, dy të tjerë ndodhen brenda mjetit që po digjet

Pamjet e siguruara nga Report Tv janë nga momenti i parë i ngjarjes nga atentati në mbikalimin e Fushë-Krujës. Një prej viktimave ka dalë nga makina tip 'Volkswagen' por nuk ka shenja jete ndërsa dy persona të tjerë ndodhen ende brenda makinës që është përfshirë nga flakët.

A.M./K.T./Shqiptarja.com

TAG: Brilant Martinaj | diklen vata | fushe kruje | Durres | 3 te vrare ne Fushe Kruje | Ervis Martinaj

Komento

Komente

Brilant2022: 17/07/2022 21:08

Te vjen keq se si po shkon ky brez dhe me keq po beher perdite, Kto tipat si brilanti dhe disa tjere keq me vjen Por i ka hyp vetja ne qef, duan te hahen me doren e vjeter Por e kane te humbur se jane 50 vjec ato.. jane me master o bir ! Rrini urte se do piqeni me keq se ky, por rrini mire Flisni me edukate dhe mundohuni ta shijoni jeten se eshte e cmuar, Mos u merrni me ato qe skane ca humbin, se do ju hane te gjalle, Ne pergjithsi dmth po ju keshilloj, jo vetem per rastin konkret. Me mend ne koke..

Përgjigju

Boba: 17/07/2022 19:52

Kjo ndodh kur shteti dhe policia shqiptare eshte e fokusuar te luftoj qytetaret e thjesht te vendit me gjoba ne vend qe te luftoj krimin e organizuar. Te dorehiqet ministri i brendshem dhe drejtori i policise! Po arrestohen te rinj per dy cigare hashash dhe te lire enden kriminelet qe mbajne peng Shqiperine. Njerez te paafte per te hetuar dhe denuar. ANTISHQIPTAR, SHPORRUNI!

Përgjigju

> **Elion:** 17/07/2022 20:24
>
> Te drejte ke o Boba, neve na cajn karin me gjoba e na bejn gangsterrin policat. Me kta pthrpshat ulin koken kur i ndalojn me makina.

shoku: 17/07/2022 18:47

Nuk do tja dije njeri se ke kushuri Vis Martinaj po ikin djem te rinj kot per lesh,ai jo shoket qe po I shet me rradhe e ortaket po tani ka fillu me fisin e tij.Eshte ceshtje kohe kur te takoheni bashke,nuk ka te forte me sot mos I bini ne qafe kot njeriu se nuk ju gjen asgje.

Përgjigju

Fresku: 17/07/2022 18:30

Po nuk te falin dukajt dhe doklia do ja presin gjitha krahet ervis bushtres,aa te jet doqia ne xhiro do vdesin shum nga keta vetem atyre te oslos si ben dot gje doqia pa keta qe jan xhiro i grin keq

Përgjigju

> **Fieri:** 17/07/2022 21:05
>
> Pse kush po I ndalon ata jan jasht te gjith memetajve u ran shpetuan per qime faqedjegurit po robit te parit shpetoi na djali e ja bente obobo ca na ben e ke ne yutub ke do tjetr ti camet te qin ne sum doqe festa cipur buzder

> **Vlonjati:** 17/07/2022 20:39
>
> Keta qe thua ti o fieri nuk hyn dot ne vlore se e din vet

> **O fieri:** 17/07/2022 20:34
>
> O fieri mos harro se ata te olsos kan cuar me pushime pa kthim 100 veta dhe akoma aty jan. Ti mos numro vetem sa nga ata te oslos kan vdek. Numro dhe nga grupi tjeter sa kan ikur me pushime. Dhe sot per sot ata jan 1shat ne vlore

> **Oslo:** 17/07/2022 20:25
>
> Ska ngel me njeri nga Oslo jo...as nje dite plazh skemi bere kete vit

> **Fieri:** 17/07/2022 20:19
>
> Po se atyre te oslos u ka ren na 4her ai apo sdi gje ti mos e di gjall gje faqedjegurin ti vlla po inin mos e di te sakt se ini esht sakat tani doqja cipuri festa dhe buzderi

1 milion €: 17/07/2022 18:08

Kshu eshte kur paguan per koke njerezish Si per koke dashi, do te vrasesh per inat, Dhe shko per lesh! Je ngatrru me njeriun e gabuar o trim. Vazhdon filmi, per pak vazhdojme me reklama....

Përgjigju

> **Pik:** 17/07/2022 18:36
>
> Vis martinaj per cudi te madhe seshte ngatrru me 1 te forte Por me te gjithe te fortit e mundshem Dhe eshte ngrit ankandi me teper se per pikturen e pikasos.. Po pastrojne dhe therrimet, spo lene gje te gjalle ne toke aq shume te mira ka bo Visi dhe pak smbetet me gje tjeter.

> **Pik:** 17/07/2022 18:22
>
> Per ca kan paguar kto ? Ne cfare njeriu jan ngaterru. Kaq i fuqishem eshte?

Rraqi: 17/07/2022 17:33

I moren perpara katundaret e Shengjergjit bashing me Suelin perpara kto mbetjet qafezeza te osmaneve

Përgjigju

> **Per lacin:** 17/07/2022 21:03
>
> Shume i sakte Laci, dhe kij besim, ska per ti lene derisa te mbarohen, se i kane vra baben e njeriut me te dashur padrejtesisht Dhe per me keq, martinaj ka pagu 1-2 milion€ per Doklen, Por se ka pase idene me te vogel se me ke eshte ngatrru Se visi eshte diletant, dokle profesor qe ne 1999.

> **Per krujen:** 17/07/2022 19:31
>
> Kush nuk ka potencial sueli me dukat? E ke gabim O kruja

> **Kruja:** 17/07/2022 18:27
>
> Edhe un ashtu besoj kruj lac ju ka ardh goditja skan potencial ata qe thu ti me bo kte te sotmen o rraqi

> **Laci:** 17/07/2022 18:27
>
> Indrit Dokle jeton me vajzen e Xhelal Recit, njeriut te vrare nga Martinajt. Ata kane tentu me vra edhe Besnikun me familje, Mihasi ishte autor. Te tri palet jane super kriminela po Martinajt kane armiq shume keto dite.

> **Kikiko:** 17/07/2022 17:48
>
> Nuk besoj se vje nga shengjergji kjo e sotmja. E kan me afer hasmin ksaj rradhe.

sociologu: 17/07/2022 17:12

KOT NUK TE VRET NJERI ..KE BERE DICKA TE KEQE....

Përgjigju

pastruesi inates: 17/07/2022 17:06

TE vriten sa me shume nga keta plehra qe na nxijne fytyren ne bote e kudo,,,TRE HALE ME PAK.....

Përgjigju

maloku i pukes: 17/07/2022 17:04

HE,, BENI SI TE FORTE TANI SE SI MINJ DO DIGJENI NE MAKINAT QE I KENI BLERE ME PARA DROGE,,DHE VRASJE,,,PO VRAVE DO VRITESH,,,GJAKU NUK HUP KURRE,,KY ESHTE NENI I PARE I KANUNIT TE LEKE DUKAGJINIT,,,MOS E HARRONI KETE NEN,,,KANUNI I LEKE DUKAGJINIT KA QENE KAQ I DREJTE SAQE ZBATOHET ME PERPIKMERI DERI NE DITET TONA....

Përgjigju

Alban: 17/07/2022 16:53

Ky Brilanti nje hale qe nuk do i mungoje askujt.Kriminel 24 karat.

Përgjigju

Vlora: 17/07/2022 16:40

O besi i shkret djal me te mir skish e ka ngren kot lumadhi i vaffte shpirti xhenet

Përgjigju

> **Shkodra:** 17/07/2022 17:14
>
> Kot ??? Nuk rri me brilantin nji djal i mir o shok , rrin ato qe jan si puna e tij

> **Aiop:** 17/07/2022 17:09
>
> Gjynof po t jet ashu , shpirti n xhehnet. Po kur e di ca problemesh e hasmerish kan ropt , I rri larg atyne Jo xhiro n makin

Visi: 17/07/2022 16:39

O Viso, coj dy paket

Përgjigju

Fushe Mamurras: 17/07/2022 16:39

Xhelal Recin e kane vra keta Martinajt se fmit e Xhelalit u kan pa plagos nje djal tjeter axhet. Visi mshehet po tjeret po e hane nje nga nji.

Përgjigju

Laci: 17/07/2022 16:33

Brilanti per vrasjen e xhulios dhe te ish efektivit reci ne lac . E ka meritu me koh plumbin . Super vrasje dhe djeg shkrumb e hi

Përgjigju

Eva: 17/07/2022 16:20

O Zot filma horror

Përgjigju

Jep dorheqjen: 17/07/2022 16:15

O minister rendi o drejtor policie . I shpallur ne kerkim per vrasjen e xhulio preles e ish efektivit reci ne lac e ju e leni te bredhi i lire . Turp haram i paci ato rroga

Përgjigju

Kast: 17/07/2022 16:15

Ee u qifsha motren e vrat policin pa pik faji u vrau gjynafi qe keni ba me djalin e shkret 22 vjec ja moret jeten ishalla shuheni si fis komplet

Përgjigju

Dritan: 17/07/2022 16:10

Nje nga keta muterit ka vrare nje djale te ri polic kot se koti para 2 vitesh ne autostrade . Inshallah i ka dale shpirti nga bytha duke u djegur legenit.

Përgjigju

Bravo: 17/07/2022 16:03

Po te keni vra brilantin ju lumshin durt e ju prift e mbara . Si puna ketyne ku ta gjesh me vra perdit nga 10 veta . Halli mos ta haje njeri kot . Brilanti ne kerkim nderkombetar per vrasjen e efektivit te policis e bridhte pa problem

Përgjigju

Kala: 17/07/2022 15:54

Nuk ka mundesi. Do kene qene tu u festu pas fjalimit te Rames qe ne ka cu aty ku sta pret mendja.

Përgjigju

Arbëri: 17/07/2022 15:37

Shumica e këtyre vrasjve është duke u bër nga vrasës me pages nga serbia...! Kështu vepron Vucici dhe kështu vepron Edvin shkjau shqipfolës.... ! Shteti ka rën në duart e kriminelve serborus dhe shqipfolësve

Përgjigju

> **Arbërori:** 17/07/2022 21:09
>
> Ju që ofendoni jeni një me Edvin shkjaun shqipfolës , por do vie koha shumë shpejt vetëm të keni durim sepse ky është Fillmore i fundit të shkjaut fashist o shqipfolës të mjerë.

> **Hahahahaha:** 17/07/2022 19:57
>
> Da kurac da!!

> **Niku:** 17/07/2022 18:04
>
> Ky arberori prej kosove di vetem te shkruaj shkjau,vucic,rama,putin,serbi,komplet injorant,i kam thene disa here lere internetin , ruaj lopen ,eshte aq i trash sa nuk degjon

> **Demir:** 17/07/2022 17:59
>
> O injorant ngele duke komentuar,vucic ,shkja,rama,serbi ,putin,.ik mor ruaj lopen çte duhet interneti,kosovar i trash

> **O arberor:** 17/07/2022 16:31
>
> Po sot ja bere nje bj albinit?

UKU MOMLIT: 17/07/2022 15:31

Karshilleku i krimit ndaj shtetit shqiptar eshte nje grope sociale e frikshme,eshte humnere e tmerrshme sociale. Kjo grope-humnere ka te instaluara strukturat e saj ne organet shteterore e ligjzbatuese prej shume e shume vitesh.

Përgjigju

Kruja: 17/07/2022 15:20

Paskan qellu ne shenj niklaxhit se qen ne qetsi ca koh

Përgjigju

Para laci: 17/07/2022 15:20

Vazhdon vis martini te paksohet ..

Përgjigju

> **H.h:** 17/07/2022 16:04
>
> Shteti e liroj por hasmi nuk fal. Vrau nje djal te ri polic dhe ja hodhi burgut. Por ka zot

Macoku: 17/07/2022 15:17

Me ba luft me Ndokajt a si me ken tu ba luft ushtria shqiptare me ufot Snjofin kundershat nokajt ne shqipri Jan pesh e rend

Përgjigju

> **Macoku:** 17/07/2022 17:57
>
> Nokajt jan macoku per mijt e haleve

> **Macoku:** 17/07/2022 17:52
>
> Tregojn veprat Nokajt jan si macoku per mijt e haleve

> **Vlonjati:** 17/07/2022 17:36
>
> Kush Nok ai qe dukej si femr Samuel noka per ate apo per ke ti po I ben sikur jan Lict qe te marin gjak ne vetll

> **Lezhjani:** 17/07/2022 16:09
>
> @Haka, Beni jo sot, por edhe përpara nuk ka pas dalë.

> **Lezhjani:** 17/07/2022 16:02
>
> Nokajt nuk i djegin makinat mbas krimit

> **Hahahaha:** 17/07/2022 15:41
>
> Po ik o k... ca pesh e rand ndokajt a e vran te dera e shpis sandrin

> **Haka:** 17/07/2022 15:37
>
> Kur osht hera e funit qe e ke pa Ben Noken ne rruge?

> **Lani:** 17/07/2022 15:23
>
> Ahahah ah te raft pika o Macok hahaha na i bone ndokajt si Skenderbeun te mart e mira

KKKriminelat: 17/07/2022 14:56

Ndokajt

Përgjigju

> **Kkkk:** 17/07/2022 15:23
>
> I ke ra gabim kesaj here o kkk

> **Kriminel:** 17/07/2022 15:11
>
> Autoret apo viktimat

Shkodra: 17/07/2022 14:45

Ja te presim kush jan emrat ! U be koh pa atentate kishim merak. Nga fush kruja ka plot qe meritojn plumbin , te shohim Kush jan

Përgjigju

© Ndalohet rreptësisht ripublikimi i këtij shkrimi, sipas nenit 80, ligji 35/2016

Sondazhi i ditës:

Jeni pro apo kundër Amnistisë Fiskale deri në 2 milionë euro që propozon Qeveria?

PRO | KUNDËR | NUK E DI

Lajme të tjera

Kronikë

I bllokohet timoni pedalones, tre 15-vjeçarë mbetin në mes të detit në Durrës! Shpëtohen nga Policia Kufitare

17 Korrik, 19:40

Kronikë



Saga e vrasjeve që s'ka fund/ Plani për ekzekutimin e tij dështoi, por rivalët po ia eliminojnë miqtë Ervis Martinajt

17 Korrik, 18:28

Opinion

Kur ndodh një ngjarje...

Lutfi Dervishi

17 Korrik, 18:05

Kronikë



U vra sot në atentatin e Fushë-Krujës, kush ishte Brilant Martinaj kushëriri i Ervis Martinaj dhe vrasja e efektivit Prela në Lezhë (FOTO)

17 Korrik, 16:07

Kronikë



Masakra me tre të vrarë në Fushë Krujë, reagon opozita: Shteti i është dorëzuar krimit! Asnjë ministër nuk justifikohet dot

17 Korrik, 15:50

Kronikë

E diela në bregdet! Trafik i rënduar drejt Gjirit të Lalëzit, Shëngjinit dhe plazheve të jugut! Radhë kilometrike automjetesh

17 Korrik, 09:24

Kronikë

Durrës/ Kontenieri me banane u gjet i hapur, mungonin rreth 50 arka! Dyshohet se kishin kokainë! 20 të arrestuar, punonjës sigurie dhe operatorë

17 Korrik, 09:13

Kronikë

Dyshohet se një grup kriminal po transportonte drogë, ndalohet një anije në Durrës

16 Korrik, 21:41

Kronikë



Hije dyshimi mbi tenderin 4 mln USD të FSHZH-së për shëtitoren e plazhit Durrës, deformohet projekti rrugës, ulet cilësia e punimeve, vendosen kritere arbitrare

Adriatik Doci

16 Korrik, 11:27

Kronikë

Kultivonte kanabis në Krujë, 20-vjeçari kapet 'mat' nga policia teksa po e ujiste! Vihet në pranga

16 Korrik, 11:18

Kronikë

Shpallet 'Dëshmor i Atdheut' Anri Kashiku, hyri në det për të shpëtuar vëllain dhe shokun e tij

15 Korrik, 16:44

Kronikë



Dhunuan një person teksa po qëndronte në dhomën e sigurisë, pezullohen 3 efektivët e 'Shqiponjave' (EMRAT)

15 Korrik, 15:17

© 2011 - 2022 Shqiptarja.com - Ndalohet riprodhimi i paautorizuar i kesaj faqeje